



Prishtinë, 27 shkurt 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_894\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 16.11.2016 për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike (në vazhdim licencim i aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike), të bërë nga ndërmarrja "Interenergo d.o.o-Kosova" SH.P.K., adresa: Sali Çeku gogaj Building, app.14, Deçan, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2017, nxori këtë:**

## VENDIM

**I. I LËSHOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "Interenergo d.o.o-Kosova" SH.P.K me numër licence ZRRE/Li\_56/16 për periudhën nga data 27 shkurt 2017 deri 26 shkurt 2022.**

## Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16.11.2016 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike nga ndërmarrja EFG.
- o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave/dëshmime të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të këtij aktiviteti dhe ka kërkuar dokumente shtesë, të cilat janë sjellë në ZRRE kohë pas kohe.
- o ZRRE i lëshon kësaj ndërmarrjeje licencë për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, pasi që Ligji Nr. 05/L-084 i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016 parasheh një aktivitet të tillë.




- Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **400 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "**Interenergo d.o.o-Kosova**" SH.P.K
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe
- Departamentit Ligjor dhe të Licencimit-ZRRE

**Bordi i ZRRE-së**

  
Krenar Bujupi, U.D kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar